



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA KORÇË**  
**NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Datë 31.10.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje elemente dekorative te ndricuar”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- Dekorime **45451000-3**

**VLERA E FONDIT LIMIT QË PROKUROHET: 3,499,333 (tre milionë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë PA TVSH**

**Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke përlogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi i parë pika b) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë**ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vleres te parashikuar te kontrates.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

---

### 2.3 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

---

### Argumentimi i specifikimeve teknike

**Termet e references, sasite, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjes për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr 500 Prot.date 25.10.2024.**

Ato janë si më poshtë:

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia
1	Element metalik ne forme lule me petale i montueshem	cope	64
2	Instalacion metalik ne forme mini shandani i montueshem	cope	20

### SPECIFIKIME TEKNIKE

#### 1. Element metalik ne forme lule me petale i montueshem

- Element metalik i montueshem ne shtylla ndricimi.
- Dimensionet e qaforeve shtrenguese Ø100mm (2 cope), te montueshme me vida.
- Numri i petaleve ne nje element 6 cope
- Rrathet mbeshtetes te petaleve me diameter 30 cm dhe 70 cm
- I lyster me antiruxho dhe boje. Ngjyra e zeze

- Petalet me dy lloj kalandrimesh (foto ilustruese), gjatesia 115cm gjeresia 40cm
- Secili element i veshur me shirita dekorative LED, me mundesi bashkimi me mufta hermetike. Largesia e dritave nga profili 5cm. Ngjyra e ndricuesve 4000K. Ngjyra e kabllit e gjelber. Standarti IP44
- Perimetri i elementit metalik i veshur me ndricim fotosuline dekorative 4000K. Trashesia e tubit 13mm. Largesia midis llampave 2.77cm. Tubi te kete tre fije teli brenda qe lidh llampat. Mundesia e prerjes te tubit, cdo 1 meter. Mbrojtja nga uji IP67


**Foto ilustruese:**



**2. Instalacion metalik ne forme mini shandani i montueshem**

- Instalacion metalik ne forme shandani i montueshem ne shtylla ndricimi.
- Dimensionet 210x135cm
- Dimensionet e qaforeve shtrenguese Ø100mm dhe Ø 145mm te montueshme me vida.
- I lyer me antiruxho dhe boje. Ngjyra e zeze
- Struktura e veshur me shirita dekorative LED, me mundesi bashkimi me mufta hermetike. Ngjyra e ndricuesve 4000K. Ngjyra e kabllit e gjelber. Standarti IP44

Foto ilustruese:



*Specifikimet teknike per “Blerje elemente dekorative te ndricuar”janë hartuar duke u konsultuar grupi i punes me Drejtorine e Turizmit,Bashkia Korce.*

*Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punes bëhen pjesë e dokumentave te tenderit.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**